

URDHËR
Nr.387, datë 20.5.2011

PËR MIRATIMIN E FORMËS DHE PËRMBAJTJES SË PROJEKTIT TË KONSERVIMIT TË MINIERËS

Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 55, pika 8 dhe nenit 56, pika 2 të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Të gjitha minierat e braktisura që sipas përcaktimeve të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”, vlerësohen si të tilla, kalojnë në regjim konservimi dhe monitorimi postmineral pas studimeve vlerësuese të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) dhe miratimit me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. AKBN-ja i propozon ministrit zonat e lejeve minerare për konservim, në bazë të një projekti konservimi. Ky projekt konservimi hartohet për objektet minerare në rastet kur:

a) minierat e shfrytëzuara nga shteti kanë akoma rezerva gjeologjike dhe procesi i shfrytëzimit mund të vazhdojë nga subjekte të interesuara;

b) vazhdimi i shfrytëzimit bëhet i papërshtatshëm për motive ekonomike;

c) zotëruesi i lejes minerare braktis veprimtarinë minerare për arsye të tij, ndërkohë që aktiviteti i shfrytëzimit në këtë objekt mineral mund të ketë përfitime ekonomike;

d) për shkaqe natyrore apo gjeologo-minerare bëhet i papërshtatshëm vazhdimi i shfrytëzimit dhe duhet të garantohet një mënyrë e re e shfrytëzimit të objektit mineral.

3. Projekti i konservimit për zonat e lejeve minerare të minierave të braktisura zbatohet nga subjekte të specializuara shtetërore ose private, të përzgjedhura sipas procedurave të prokurimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Kontrolli i zbatimit të projektit të konservimit kryhet nga AKBN-ja.

5. Procedurat e konservimit të një objekti mineral të braktisur, bëhen sipas projektit të konservimit të miratuar, në zbatim të kërkesave të nenit 55 të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”.

6. Projekti i konservimit duhet të mbështetet në parimet e:

a) mbrojtjes dhe konservimit të punimeve të realizuara në objektin mineral dhe të rezervave minerare si burime të papërsëritshme.

b) marrjes së masave parandaluese dhe mbrojtëse për jetën dhe shëndetin e komuniteteve në zonë, ndotjes në tokë, në ujërat, të florës e faunës, mjedisit dhe ekosistemit në përgjithësi, si dhe të infrastrukturës.

c) Këshillimit me autoritetet e qeverisjes vendore.

d) Bashkërendimit ndërmjet mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit ekonomik.

7. Projekti i konservimit të një miniere të braktisur, hartohet nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) dhe miratohet nga Ministri.

8. Forma dhe përmbajtja tip e projektit të konservimit të objektit mineral do të jetë sipas aneksit 1, bashkëlidhur këtij urdhri.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet institucioni i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN).

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
Nasip Naço